
1 HYRJE

Në këtë manual janë përshkruar karakteristikat elementare të programit COBISS3, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha modulet. Gjithashtu, janë paraqitur disa karakteristika të lidhura me modulën COBISS3/Katalogimi (të gjitha karakteristikat që kanë të bëjnë me ndërfaqen e përdoruesit, hollësisht janë përshkruar në manualin *COBISS3/Katalogimi*; shih kap. 3–5).

Instalimi i programit

Për të hapur programin COBISS3 duhet të sigurohen kërkesat minimale për harduer e softuer. Për instalimin e ndërfaqes së përdoruesit ju nevojitet qasja në internet.

Ndërfaqja e përdoruesit

Komponentet e ndërfaqes së përdoruesit të programit COBISS3 janë:

- ***shfletuesi***, i cili prezanton dritaren bazë të ndërfaqes së përdoruesit dhe mundëson përzgjedhjen e moduleve dhe klasave si dhe navigimin midis objekteve, ekzekutimin e metodave të përgjithshme tek klasat dhe objektet
- ***dritarja për kërkim***, e cila mundëson kërkimin e objekteve të klasës së përzgjedhur
- ***redaktuesi***, i cili mundëson shënimin e të dhënave dhe ndryshimin e vlerave tëtributeve të objektit të përzgjedhur dhe objekteve të përfshira, caktimin e lidhjeve, kontrollimin e objekteve të përfshira dhe objekteve të lidhura me objektin e përzgjedhur
- ***ndërfaqja për katalogim***, e cila mundëson procedurat e përpunimit të burimeve bibliografike dhe procedurat e punës me regjistrimet e njësuara (është përshkruar në manualin *COBISS3/Katalogimi*; shih kap. 3)
- ***paraqitësi***, i cili mundëson paraqitjen e veçorive të objektit të përzgjedhur, objekteve të përfshira dhe objekteve të lidhura me objektin e përzgjedhur

Procedurat bazë

Në të gjitha modulet mund të ekzekutohen këto procedura bazë:

- krijimi i objektit
- vendosja dhe ndryshimi i veçorive të objektit
- kërkimi
- paraqitja e veçorive të objektit
- përgatitja dhe dërgimi i raportit

<i>Parametrat</i>	Parametrat e paracaktuar gjatë instalimit të programit mund të ndryshohen: ndryshohet lloji i shkrimit dhe madhësia e tij, dimensionet e dritareve, destinacionet që respektohen gjatë dërgimit të raporteve etj.
<i>Udhëzimet për shënimin e të dhënave</i>	Tek shënimi i simboleve dhe të dhënave të formatuara, duhet të respektohen rregullat e caktuara.
<i>Shtojcat</i>	Shtojca A përmban udhëzimet bazë për punë në mjedisin Windows, ndërsa shtojca B listën e shkurtimeve (tasteve të nxehta) për ekzekutimin e disa procedurave dhe metodave.